



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 694 / prot.
6

Tiranë më 13.9.2022

VENDIM

Nr. 28, datë 19.9.2022

PËR KONTROLLUESIN “DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave” (në vijim, “Kontrolluesi” ose “DPD”).

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 52, datë 01.04.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Verifikimi i procesit të përpunimit të të dhënave personale në kuadër të aksesit që ka Kontrolluesi në të gjitha databazat shtetërore veçanërisht në sistemin TIMS; në Regjistrin e Gjendjes Civile dhe zbatimi i detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është institucion shtetëror, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe ushtron veprimtarinë në zbatim të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. DPD ofron shërbim përmes degëve doganore dhe zyrave doganore.

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave personale për kategoritë: “nëpunës”, “personat që hyjnë dhe dalin në territorin e Republikës së Shqipërisë”, “pamjet e siguruar (individë) nga Sistemi Dixhital i Video Survejimit”, “Të dhënat e përpunuara nga databazat në të cilat ka akses DPD (TIMS, e-Albania)”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi ka krijuar sisteme elektronike në të cilin kryen aktivitetet funksionale brenda fushës së veprimtarisë. Sistemet elektronike bazë të funksionimit të veprimtarisë së institucionit kryhen nëpërmjet sistemit ASYCUDA WORLD e cila proceson deklaratat doganore, Sistemi LIMS, që realizon në mënyrë elektronike analizimin e mostrave doganore, Sistemi SEED i cili shërben për shkëmbimin e informacionit mbi llojet e mallrave me vendet e tjera, Databaza Oracle Application, Databaza e borxhit, etj. Gjithashtu, Kontrolluesi ka implementuar sistemin dixhital të video survejimit në Degët Doganore (ky sistem monitorohet nga Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, pjesë e DPD, por nën administrimin e drejtorisë TIK të AKSHI-t, pranë DPD). Njëkohësisht, Kontrolluesi ka akses në Sistemin e Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS) si dhe në Regjistrin e Gjendjes Civile apo regjistra të tjerë, përmes portalit unik qeveritar e-Albania.

Nga analiza e dokumentacionit rezulton se, bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 24 i ligjit nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar (në vijim, “VKM nr. 673”), është përpiluar “Marrëveshja Operacionale e Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” me nr. 4130 prot., datë 18.02.2019 (numri i protokollit të DPD-së).

Nga verifikimi i Marrëveshjes së sipërcituar, rezulton se ky akt nuk plotëson kërkesat formale të veprimit juridik, pasi është nënshkruar vetëm nga DPD dhe jo nga AKSHI, për rrjedhojë, ky akt nuk dokumenton dakordësinë e të dy palëve.

Kontrolluesi në shkresën me lëndë: “Informacion mbi sistemet në funksion të Administratës Doganore Shqiptare”, pretendon se, referuar zbatimit të VKM nr. 673, Infrastruktura Hardware dhe Software ka kaluar tek AKSHI.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, kalimi i infrastrukturës Software dhe Hardware nën administrimin e AKSHI-t dhe angazhimi i këtij institucioni (të përcaktuar me akt nënligjor) nuk përjashton Kontrolluesin DPD, nga përgjegjësitë për të mbikëqyrur dhe monitoruar aspektet e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, që Kontrolluesi është i autorizuar të përpunojë dhe administrojë me ligj. Për sa më sipër, bazuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit, DPD mbart detyrimin kryesor për marrjen e masave tekniko-organizative për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

Ndërkohë, nga konstatimi i Grupit të Hetimit rezulton se, nga analiza e inventarit të aktiveve të vendosur në dispozicion nga përfaqësuesit e Kontrolluesit përmes email-it të datës 01.06.2022, e gjithë infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit është pjesë e Inventarit të Aktiveve të institucionit DPD.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, mungesa e finalizimit të procesit të transferimit të aktiveve, në kundërshtim me parashikimin e pikës 18, të VKM nr. 673, e cila përcakton se *“Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018”*, sjell si pasojë mos garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale që përmbajnë këto sisteme, bazuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit.

3. Kontrolluesi ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 13620 prot., datë 30.09.2010, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH) dhe DPD *“Për dhënien e të drejtës së përdorimit të Sistemit të Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS) të Policë së Shtetit dhe dhënies së të drejtës së përdorimit të bazës të të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme Doganave (Oracle Application Reports)”*, sipas së cilës, DPD ka të drejtë akses vetëm për konsultim, në modulën *“Hyrje-Dalje Automjetesh”*, në sistemin TIMS.

Me tej, në zbatim të detyrimeve ligjore si dhe Marrëveshjes së vitit 2010, Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar Urdhrin nr. 42, datë 09.10.2017 *“Për miratimin e listës së funksioneve organike të administratës doganore të cilët duhet të kenë akses në sistemin TIMS”*, (në vijim, *“Urdhër nr. 42”*) në të cilën përcaktohen pozicionet e punës dhe numri i punonjësve që duhet të kenë akses konsultimi në TIMS.

Nga verifikimi në listën e vendosur në dispozicion nga DPD, sipas shkresës me nr. 4266/1 prot., datë 19.06.2020, rezulton se kanë akses me tepër punonjës se sa parashikohet në përmbajtje të Urdhrit nr. 42, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Në vijim, palët kanë nënshkruar Urdhrin e përbashkët nr. 7231 prot., datë 14.04.2022 *“Për miratimin e rregullave për bashkëpunimin për kryerjen e procedurave dhe veprimeve të përbashkëta të autoriteteve të Policisë dhe autoriteteve Doganore”*, sipas së cilës, në Kapitullin IV, në pikat 1 dhe 2, të nenit 15, janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet sa i takon aksesit në sistemin TIMS. Konkretisht, DPPSH ofron akses dhe të drejtë konsultimi në sistemin TIMS, sipas fushës së veprimtarisë për qëllime doganore për 3 (tre) punonjës të Drejtorisë Antitrafik dhe 3 (tre) të Drejtorisë së Hetimit. Gjithashtu, në këtë sistem ofrohet akses me të drejtë konsultimi në modulën

“Hyrje-Dalje Automjetesh”, për 2 (dy) punonjës të autorizuar në çdo degë doganore të RSH-së.

Ndërkohë, edhe me marrëveshjen e re, të rinovuar midis palëve, pas verifikimit të listave të vendosura në dispozicion nga DPD përmes korrespondencës elektronike të datave 04.05.2022 dhe 11.05.2022, rezulton se, në sistemin TIMS kanë akses edhe punonjës që i përkasin Drejtorive që nuk janë të parashikuara në Urdhrin e Përbashkët nr. 7231 prot., datë 14.04.2022, si dhe në disa Degë Doganore kanë akses më shumë se 2 punonjës.

Kontrolluesi nuk garanton sigurinë e të dhënave personale, për shkak se, aksesit në sistemin TIMS, i është dhënë një numri më të madh punonjësish, apo sektorëve brenda DPD-së, duke mos ju përmbajtur parashikimeve të marrëveshjeve të nënshkruara midis palëve.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, është përgjegjësi e Kontrolluesit për të verifikuar nëse masat për sigurinë e të dhënave personale janë përmbushur, siç parashikohet në pikën 1 të tij: *“Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”*.

4. Nga verifikimet on-site të sistemit TIMS rezulton se, punonjësit e DPD, në Drejtorinë e Hetimit, kanë të drejtë të kërkojnë në modulën “Hyrje-Dalje Automjetesh”, të dhënat e shoferit të automjetit, me emër, mbiemër, gjini, nr. i shasisë dhe targa automjetit. Konstatohet se kontrolluesi nuk ka një procedurë të rregulluar, me qëllim gjurmimin e çdo veprimi të punonjësve të autorizuar që kanë akses sistemin TIMS, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo proces përpunimi i të dhënave personale (veçanërisht çështja a gjurmueshmërisë së aksesit në sisteme të një rëndësie të veçantë, si “TIMS”), duhet të mbështetet në parimet dhe kriteret e përpunimit të parashikuara përkatësisht në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Përgjegjësia për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale qëndron për çdo institucion publik që ka akses në të dhënat në sistemin TIMS dhe që administron këtë sistem. Një nga masat kryesore për garantimin e sigurisë së të dhënave personale dhe konfidencialitetit të të dhënave është edhe gjurmueshmëria e veprimeve përpunuese dhe verifikimi i vazhdueshëm i saj, me qëllimin për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit.

Gjurmueshmëria e veprimeve përpunuese është e rëndësishme për t'i mundësuar Kontrolluesit realizimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore për të garantuar konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale të cilat akseson, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore specifike. Kjo për të shmangur edhe pasojat e rënda që mund të vijnë në rast të aksesit ose përhapjes së paligjshme të të dhënave nga punonjësit e DPD-së, që kanë akses në të dhëna.

Nga verifikimi i kryer rezulton se, në rastin e kërkimit në sistemin TIMS, me emër-mbiemër shfaqen të dhëna, ku përfshihen edhe të dhëna personale (*emër, nr. dokumenti, datëlindje, gjini*) të individëve me po të njëjtin emër-mbiemër me personin nën hetim. Në rastin e kërkimit me targën e automjetit ose me nr. e shasisë shfaqen edhe të dhënat personale të individëve të cilët kanë qenë bashkë-udhëtar në automjetin e kërkuar, por që nuk janë subjekt hetimi nga DPD, në kundërshtim këto me parimin e mjaftueshëmerisë sipas germës “c” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi ka detyrim që të përpunojë ato të dhëna që ka të nevojshme për të arritur qëllimin duke respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale lidhur me mjaftueshmërinë e të dhënave, sanksionuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, në të cilin parashikohet se mbledhja dhe përpunimi i të dhënave duhet të lidhet me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

5. Kontrolluesi bazuar në ligjin nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, VKM nr. 495, datë 13.9.2017 “*Për miratimin e Rregullave të Përfitimit të Shërbimeve Publike Elektronike*”, si dhe Udhëzimin e përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 “*Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 463*”), të Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, ka akses në Regjistrin e Gjendjes Civile, përmes portalit qeveritar e-Albania, me qëllim lehtësimin e procedurave për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve publike elektronike nëpërmjet shërbimit të transmetimit elektronik të sigurt për qytetarët dhe institucionet publike.

Në vijim, nga ana e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është nxjerrë Urdhri nr. 101/1, datë 02.10.2017 “*Për lehtësimin e kërkesave dokumentare të shërbimeve të ofruara ndaj biznesit dhe qytetarëve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Institucionet në varësi të saj*”, në germën m, të pikës 1, të të cilit përcaktohet se “*të gjitha strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Institucionet e saj të varësisë, për çdo shërbim të ofruar ndaj qytetarëve dhe/ose sipërmarrjes, do të gjenerojnë nga Regjistri i Gjendjes Civile, të gjitha llojet e certifikatave*”.

Konstatohet se, nga krahasimi i përmbajtjes të Urdhrit nr. 101/1, datë 02.10.2017 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Udhëzimit nr. 463, ka mospërputhje lidhur me aksesin/kategorinë e të dhënave që mund të përpunojnë punonjësit e DPD.

Grupi i hetimit administrativ konstatoi se, pavarësisht, se Udhëzimi nr. 463, e ka kufizuar kategorinë e të dhënave (*emër, mbiemër, nr. personal, atësi, amësi, datëlindje, vendbanim (adresa), apo të dhëna të tjera që lidhen me çështjen në shqyrtim*) në të cilat duhet të kenë akses punonjësit e DPD, në Regjistrin e Gjendjes Civile, efektivisht rezulton se, punonjës të caktuar kanë akses në portalin e-Albania në rolin “*Administratë*”, me attribute kërkimi më shumë se sa parashikon akti nënligjor i sipërcituar, gjithashtu përtej nevojës për të përmbushur detyrat funksionale. Konkretisht, punonjësit kanë akses, ndër të tjera, në gjenerimin e certifikatës familjare, certifikatë nga akti i lindjes dhe certifikatë nga akti i martesës.

Njëkohësisht, konstatohet se, punonjësit e DPD-së, përmes portalit e-Albania kanë akses në 31 module, përfshirë edhe në kartën e shëndetit, e cila përmban, ndër të tjera, edhe të dhëna sensitive, në lidhje diagnostikimin me Sars-Cov2 të subjektit të të dhënave, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave, kriteret ligjore të përpunimit, si dhe përpunimi i të dhënave sensitive, të parashikuara në nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave që kryen Kontrolluesi përmes aksesit në portalin e-Albania, nuk është në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim, të sanksionuar në nenin 5, germa 1/c, e Ligjit. Aksesit i Kontrolluesit në këtë portal duhet të kufizohet vetëm në ato të dhëna, të cilat lidhen thellësisht me qëllimin specifik të përpunimit, në përputhje me detyrat funksionale respektive, si dhe në harmoni me kategorinë e të dhënave të përcaktuara në Aneksin 1, të Udhëzimit nr. 463.

6. Kontrolluesi në faqen zyrtare <https://www.dogana.gov.al/> nuk ka publikuar “*Politikat e Privatësisë*”. Subjektet e të dhënave personale nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare, ka detyrimin që të publikojë “*politikat e privatësisë*”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes online të internetit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e

këtij detyrimi nga ana e kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

7. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezultoi se, Kontrolluesi ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit por, konstatohet se nuk është kryer përditësimi i njoftimit në rubrikat, si më poshtë:

- Deklarimin në rubrikën 1.1, të formularit të njoftimit “*Të dhënat e subjektit kontrollues*”;
- Deklarimin në rubrikën 1.2, të formularit të njoftimit “*Personi i kontaktit ngarkuar nga subjekti*”;
- Deklarimin në rubrikën 3.1, të formularit të njoftimit “*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”;
- Deklarimin në rubrikën 4, të formularit të njoftimit “*Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*”;
- Deklarimin në rubrikën 7.1, të formularit të njoftimit “*Marrësi i të dhënave personale*”;
- Deklarimin në rubrikën 10.1, të formularit të njoftimit “*Masat e Sigurisë dhe Politikat e Ruajtjes së të dhënave personale*”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

8. Kontrolluesi nuk disponon rregullore “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, ku të parashikohen proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative, afatet e ruajtjes së të dhënave sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një “*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektsh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

9. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për

mbrojtjen e të dhënave personale. Konstatohet mosplotësim i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara në Udhëzimin nr. 47, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*), për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

10. Kontrolluesi ka instaluar dhe përdor për mbikëqyrje dhe regjistrim sistemin e *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrim”* në ambientet e Degëve Doganore, të shpërndara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i përdorimit të sistemit të *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrim”*, i cili kryen përpunimin e imazheve të cilat janë të dhëna personale me karakter të veçantë fizik, është *“parandalimi, zbulimi dhe ndëshkimi i tregtisë të paligjshme dhe kontrabandës së mallrave, mbrojtja e shëndetit publik, mbrojtja e konsumatorit dhe ambientit, evidentimi i shkeljeve të kodit të etikës nga ana e personelit doganor, siguria e punonjësve dhe e pronës së administratës doganore”*.

Kontrolluesi ka hartuar Udhëzimin nr. 4, datë 06.06.2017 *“Për monitorimin, regjistrimin, dhe administrimin e të dhënave të sistemit të monitorimit me kamera”*, ku parashikohen metodat e punës dhe procedurat standarde të monitorimit, regjistrimit, transmetimit dhe administrimit të pamjeve nëpërmjet sistemit të *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrim”*.

Nga analiza e Udhëzimit nr. 4, datë 06.06.2017 *“Për monitorimin, regjistrimin, dhe administrimin e të dhënave të sistemit të monitorimit me kamera”*, rezulton se, nuk janë të parashikuara afatet e ruajtjes së regjistrimeve të kamerave. Në sistemin e *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrim”* rezultoi se, kishte pamje filmike edhe të kohëve të mëparshme (administruar me prova, data 12 Shtator 2018). Nga ana e Kontrolluesit është pretenduar se të gjithë degët doganore janë të pajisura me tabela informuese, të cilat informojnë subjektet e të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-surveimit (CCTV), por Grupi i hetimit konstatoj se, në DPD dhe në ambientet e Drejtorisë së Hetimit nuk ka tabelë informuese.

Këto konstatime vijnë në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010, të Komisionerit mbi *“Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*, i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 3”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-surveimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Kontrolluesi duhet të parashikojë afatin e ruajtjes së të dhënave personale, të përpunuara nga sistemi i video-surveimit (CCTV), sipas parashikimit në Udhëzimin nr. 3 dhe në momentin që ky afat ka përfunduar lind detyrimi të realizojë shkatërrimin/fshirjen e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm.

Nga informacioni i vendosur në dispozicion nga Kontrolluesi, konkretisht “*Raport mbi situatën aktuale në fushën e Teknologjisë së Informacionit për Administratën Doganore Shqiptare*”, rezulton se, për Sistemin Dixhital të Video Surveimit në Degët Doganore, nuk është realizuar procesi i mirëmbajtjes periodike të sistemit.

Gjithashtu, sipas pikës 2, të VKM nr. 710, datë 21.8.2013 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, çdo institucion i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit/mirëmbajtjes të sistemit. Bazuar në nenin 27 të Ligjit, DPD mbart detyrimin kryesor për marrjen e masave tekniko-organizative për të garantuar sigurinë e të dhënave personale.

11. Kontrolluesi nuk ka marrë masa për të zbatuar rekomandimet e lëna në Rekomandimin nr. 07, datë 24.05.2013 të Komisionerit, për Kontrolluesin “*Drejtoria e Përgjithshme e Doganave*”, pasi të dhënat e siguruara nëpërmjet sistemit të video-surveimit (CCTV), ruhen përtej afatit maksimal të parashikuar në Udhëzimin nr. 3 dhe nuk informon subjektet e të dhënave personale mbi prezencën e CCTV-ve.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare nëpërmjet shkresës nr. 694/5 prot., datë 22.06.2022.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit u paraqitën në seancën dëgjimore, nuk paraqitën pretendime me shkrim dhe parashtruan argumentet si më poshtë, të reflektuara edhe në procesverbal:

1. *Referuar pikës 4 të konstatimeve të grupit të hetimit (Akses në sistemin TIMS): “Bazuar në shkresën nr. 4266/1 datë 19.06.2020 “Lista emërore e punonjësve” me ndryshimet e pësuara (largimet, transferimet, etj.) nga totali 33 punonjës që ju është dhënë akses nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, aktualisht është 30”.*

Lidhur me këtë pretendim të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se, pavarësisht masave të marra për reduktimin e numrit të punonjësve që kanë akses në Sistemin TIMS, bazuar në provat e administruara rezulton se, gjithsesi ky akses tejkalon përcaktimet e Urdhrit të përbashkët nr. 7231/2022, sipas së cilës, DPPSH ofron akses dhe të drejtë konsultimi, sipas fushës së veprimtarisë për qëllime doganore për 3 (tre) punonjës të Drejtorisë Antitrafik dhe 3 (tre) të Drejtorisë së Hetimit si dhe për 2 (dy) punonjës të autorizuar në çdo degë doganore të RSH-së.

2. *Referuar pikës 3 të konstatimeve të grupit të hetimit (Mbi kalimin e Infrastrukturës Hardware dhe Software tek AKSHI): “Bazuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, pika 2 citon: AKSHI përfaqëson pronarin-shtet dhe administron çdo sistem hardware dhe infrastrukturën software në fushën TIK, për institucionet shtetërore.”*

Lidhur me këtë pretendim të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se, angazhimi i përpunuesve/bashkëkontrolluesve të tjerë (të përcaktuar me akt nënligjor) nuk çliron Kontrolluesin nga përgjegjësitë për të mbikëqyrur dhe monitoruar aspektet e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, sipas argumentimit ligjor të sipërcituar, parashtruar pikën 2 të këtij Vendimi.

3. *Në lidhje me pikën 11 të konstatimeve të grupit të hetimit (Afatet e ruajtjes së të dhënave në sistemit të “Kamerave Vëzhgim-Regjistrim”), përfaqësuesi i Kontrolluesit paraqiti pretendimin se, në Udhëzimin nr. 3 datë 05.04.2016, “Për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave”, është përcaktuar afati i ruajtjes së të dhënave që përmban sistemi i video-survejimit.*

Lidhur me këtë pretendim të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se, nga shqyrtimi i përmbajtjes së Udhëzimit nr. 4, datë 06.06.2017 të DPD-së “Për monitorimin, regjistrimin, dhe administrimin e të dhënave të sistemit të monitorimit me kamera”, në rubrikën e dispozitave përfundimtare përcaktohet se, Udhëzimi nr. 3, datë 05.04.2016 i DPD-së, “Për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave” shfuqizohet, për pasojë afatet e ruajtjes së të dhënave, që përmban sistemi i video-survejimit, të përcaktuara në Udhëzimin nr. 3, datë 05.04.2016 të DPD-së, nuk janë më ligjërisht të aplikueshëm.

Ndërsa lidhur me konstatimet e tjera të parashtruara në procesverbal, rezulton se nga ana e Kontrolluesit nuk janë paraqitur argumente apo prova të tjera shtesë.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave "a", "b", "d" dhe "dh" të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridik, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen në veçanti me zbatueshmërinë e masave teknike dhe organizative në proceset përpunuese dhe me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Gjithashtu, Vendimi i Komisionerit bazohet edhe në faktin që, Kontrolluesi nuk ka marrë masa për të zbatuar rekomandimet e lëna në Rekomandimin nr. 07, datë 24.05.2013 të Komisionerit, për Kontrolluesin "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave",

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 7, 18, 21, 27, 28, 29, 30, 39 pika 1, gjerat "a", "b", "d" dhe "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 480 000 (katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit si dhe në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit;

- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
- 4- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 240 000 (dyqind e dyzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit;
- 5- Kontrolluesi, të përcaktojë në mëyrë të qartë databazat në të cilat legjitimohet të ketë akses dhe kategoritë e të dhënave që duhet të aksesoj në secilën databazë si dhe të marrë masa të menjëhershme në drejtim të ndalimit të aksesit të paligjshëm, në ato databaza, aksesit në të cilat, është në tejkalim të parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave, sipas parashikimit në germën “c” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
- 6- Kontrolluesi, të marrë masa konkrete për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, në zbatim të nenit 18 të Ligjit;
- 7- Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave të siguruar nëpërmjet sistemit të video-survejitimit (CCTV), duke zbatuar parashikimet e Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit;
- 8- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
- 9- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojë “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
- 10- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të tij si dhe sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 11- Kontrolluesi, duhet të marrë masa tekniko-organizative në mënyrë që të mbikëqyr dhe monitoroj aspektet e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit.
- 12- Kontrolluesi, duhet të marrë masa për gjurmueshmërinë e veprimeve përpunuese dhe për të limituar aksesin e punonjësve në Sistemin TIMS, sipas përcaktimeve të Urdhrit të Përbashkët nr. 7231 prot., datë 14.04.2022 “Për miratimin e rregullave për bashkëpunimin për kryerjen e procedurave dhe veprimeve të përbashkëta të autoriteteve të Policisë dhe autoriteteve Doganore”;

13- Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:

- (i) Menjëherë, detyrimet e treguara në pikat 5, 11 dhe 12 më sipër;
- (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 6, 7 dhe 8 më sipër;
- (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 9 më sipër;
- (iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 10 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti.

14- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

15- Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;

16- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 19. 9. 2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

3
1

